



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:026626
Datë: 28.02.2024
Numri i dokumentit: 05387642

CA.nr.2023/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti – kryetare e kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Besnik Feka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit të sigurimit M.K., nga fsh. R.... i M....., Komuna Lipjan, të cilin e përfaqëson me autorizim I.S., avokat nga Prishtina, kundër kundërshtarëve të sigurimit Q.K., dhe B.K., që të dy nga fsh. R.... i M..... Komuna Lipjan, këtë të fundit me autorizim e përfaqëson N.G., avokat nga Lipjani, për anulim kontrate, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr.87/2022, të datës 30.11.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e propozuesit për masë të sigurisë M.K., nga fsh. R.... i M....., Komuna Lipjan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr.87/2022, i datës 30.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, C.nr.87/2022, të datës 30.11.2023, ka vendosur si vijon:

‘‘I.REFUZOHET propozimi i propozuesit të sigurimit M.K., nga fsh.R..... i M....., për caktimin e masës së sigurisë, përmes së cilës ka kërkuar që t’i ndalohet kundërshtarëve të sigurimit Q., dhe B.K., nga fsh R..... i M....., K.Lipjan, t’iu ndalohet tjetërsimi në çfarëdo mënyre

i palujtshmërisë-parcelës kadastrale nr.XXX-1, në vendin e quajtur "Q.....", në sip. Prej 0.05.04 ha, prej së cilës sipërfaqe në shtëpi 0.01.05 ha dhe obor 0.03.89 ha, si dhe parcelën kadastrale nr.XXXX-3 në vendin e quajtur "Q.....", në sipërfaqe prej 0.03.84 ha, që gjithsejt bëjnë 0.08.88 ha, të regjistruara në listën poseduese nr.XXX ZK Lipjan.

II.Anulohet aktvendimi i kësaj gjykate për caktimin e masës së përkohshme C.nr.87/22 i datës 11.02.2022.

III.Procedura në këtë çështje juridiko - kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës''.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë përfaqësuesi i paditësit-propozuesit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën e propozuesit të masës së sigurimit ta aprovoj si të bazuar, dhe të nxjerrë aktvendim mbetet në fuqi aktvendimi mbi caktimin e masës së përkohshme të sigurisë C.nr.87/22 i datës 11.02.2022, deri në vendosjen meritore të kërkesëpadisë.

Përgjigje në ankesën e propozuesit ka paraqitur i autorizuari i kundër propozuesit të dytë, av.N.G., me propozim që ankesa e propozuesit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, si dhe analizimin dhe vlerësimin e shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se :

-Ankesa e paditësit - propozuesit të masës së sigurimit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi-propozuesi i masës së sigurimit, përmes të autorizuarit të tij, pranë gjykatës së shkallës së parë, ka parashtruar padi me datë 10.02.2021, kundër të paditurve Q.K., dhe B.K., që të dy nga fsh. R..... i M..... Komuna Lipjan, për anulimin e kontratës dhe vërtetimin e pronësie, bashkë me propozimin për caktimin e masës së përkohshme, me të cilën ka kërkuar që gjykata të caktoj masën e sigurisë ashtu që t'iu ndalohet kundërshtarëve të sigurimit Q., dhe B.K., nga fsh R..... i m....., K.Lipjan, t'iu ndalohet tjetërsimi në çfarëdo mënyre i palujtshmërisë - parcelës kadastrale nr.XXX-1, në vendin e quajtur "Q.....", në sip. Prej 0.05.04 ha, prej së cilës sipërfaqe në shtëpi 0.01.05 ha dhe oborr 0.03.89 ha, si dhe parcelën kadastrale nr.XXXX-3 në vendin e quajtur "Q.....", në sipërfaqe prej 0.03.84 ha, që gjithsejt bëjnë 0.08.88 ha, të regjistruara në listën poseduese nr.XX ZK Lipjan.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme, jashtë seancës gjyqësore me aktvendimin C.nr.87/22 të datës 11.02.2022, e ka aprovuar propozimin e propozuesit dhe ka caktuar masën e përkohshme. Duke vepruar sipas kundërshtimit të datës 18.02.2022 të ushtruar nga kundër propozuesit, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore të datës 07.04.2022, për të shqyrtuar propozimin e propozuesit dhe kundërshtimet e palëve kundër propozuese. Pas kësaj gjykata ka marrë aktvendimin C.nr.87/22

të dt.13.03.2023, me të cilin e ka obliguar propozuesin në deponimin e shumës së garancionit për masën e propozuar të sigurimit, nën pasojat që nëse shuma e caktuar nuk paguhet në afatin e caktuar nga gjykata, propozimi i propozuesit do të refuzohet i pabazuar.

Duke qenë se propozuesi i masës së sigurimit edhe pas kalimit të afatit të përcaktuar nga gjykata dhe nga dita e nxjerrjes së aktvendimit mbi caktimin e garancionit, nuk ka vepruar konform tij, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktvendimin C.nr.87/22 të dt.30.11.2023, me të cilin e ka refuzuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit ankimor.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ka theksuar se gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore dhe më pastaj e ka obliguar propozuesin në deponimin e shumës për garancinë, si kusht që të vendoset masa e sigurimit, mirëpo nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi ka kaluar afati kohor brenda të cilit propozuesi, përkatësisht i autorizuari i tij, ka qenë i obliguar që të veproj, ndërsa që nga shkresat e lëndës nuk kanë ekzistuar prova që të jetë vepruar sipas vendimit të gjykatës respektivisht se propozuesi ka deponuar shumën e garancisë së kërkuar në llogarinë e KGJK-së. Për mënyrën e vendosjes si në aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 297 par.3 dhe 306 par.3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Në këtë drejtim, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, me dispozitën e nenit 297, paragrafi 1 pika a) dhe b) dhe 297 paragrafi 2 të LPK, përcaktohet në mënyrë të qartë se *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se plotësohen në mënyrë kumulative tri kushte dhe atë: besueshmëria ekzistimit të kërkesës apo të së drejtës subjektive, ekzistimi i rrezikut se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës dhe deponimi i garancionit”*. Në çdo rast kur nuk plotësohet ndonjëri nga kushtet e sipër theksuara atëherë gjykata nuk mund të vendosë për aprovimin e kërkesës për sigurimin e kërkesëpadsë.

Meqenëse, aktvendimi ankimor përmban dispozitiv të kuptueshëm, ndërsa në arsyetim janë paraqit arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet të cilat kanë qenë me rëndësi për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore, për këtë arsye thëniet e propozuesit të sigurimit lidhur me atë se aktvendimi ankimor është rrjedhojë e shkeljeve qenësore nga dispozitat e nenit 182 par.1 dhe 182 par.2, pika n) të LPK-së, janë të pabazuara dhe si të tilla janë refuzuar.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit e pranon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për mos caktimin e masës së sigurimit, për shkak se gjykata e shkallës së parë e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme përfundimin e saj për refuzimin e caktimit të masës së sigurimit. Kjo për

faktin se nga provat në shkresat e lëndës nuk kanë ekzistuar prova që do të vërtetonin se propozuesi ka vepruar sipas aktvendimit të gjykatës mbi deponimin e shumës së garancisë, ashtu siç e ka caktuar në llogarinë përkatëse, edhe pse ka kaluar afati brenda të cilit propozuesi ka pasur obligim që të veproj. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 297 paragrafi 3 të LPK-së me të cilën është e përcaktuar se: *''Po qe se propozuesi nuk jep garanci brenda afatit të caktuar gjykata e refuzon propozimin për caktimin e masës së sigurimit''*, e që pasusi i mëtejme i kësaj dispozite me të cilin përcaktohet se: *''Me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta liroj atë nga detyrimi i dhënies së garancisë po qe se konstatohet se nuk ka mundësi financiare për një gjë të tillë''*, është konsumuar tani më, pasi që u vërtetua se propozuesi me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshme se nuk ka mundësi financiare, në mënyrë që gjykata ta liroj nga ky detyrim.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të paraqitura në ankesë, por ka gjetur se janë të pathemelta dhe se nuk ndikojnë që gjykata të merre një vendim ndryshe.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.2023/2024, me datë 27.02.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti d.v,